


# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6877  
E premte, 21 prill 2023  
Çmimi 0.40

Escobari thotë se  
do t'i njohin rezultatet e  
zgjedhjeve në veri **IFAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ARRESTIMI I DREJTORIT TË KEK-ut PËRPLAS POZITËN DHE OPOZITËN NË KUVEND **IFAQE 4-5**



Deputetët e opozitës kanë kërkuar nga zyrtarët e qeverisë të japin më tepër informacione për arrestimin e drejtorit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Nagip Krasniqi, pasi, sipas tyre, ai ka qenë zyrtar i lartë i Lëvizjes

Vetëvendosje. E kryeministri Albin Kurti tha se pati një gëzim opozitar për arrestimin e Nagip Krasniqit. "Ka pasur shumë kryeshefa në KEK në të kaluarën, ka pasur keqpërdorime marramendëse, por asnjëherë nuk

janë trajtuar nga sistemi i drejtësisë, përkatësisht nga prokuroria", ka thënë Kurti. Prokuroria Speciale ka kërkuar paraburgim për drejtorin e KEK-ut i cili po dyshohet për tri vepra penale



MYFTIU I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS, NAIM TËRNAVA, I KA URUAR BESIMTARËT MYSLIMANË NË PRAG TË FESTËS SË FITËR BAJRAMIT

## VENDI YNË TË BËHET VEND KU JETOHET E PUNOHET ME DINJITET

## KQZ-ja AKREDITON RRETH 360 VËZHGUËS PËR ZGJEDHJET NË VERI



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)


**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



SHEFI I NATO-s ZBRET NË UKRAINË  
PËR TA SHPREHUR MBËSHTETJEN E  
ALEANCËS **F.2**

KOMISIONI EVROPIAN PËRSHËNDET  
NËNSHKRIMIN E LIBERALIZIMIT TË  
VIZAVE PËR KOSOVËN **F.3**

QEVERIA, PAKO TË RE  
MBËSHTETËSE PËR KOMUNITETET  
JOSHUMICË **F.3**

### EKONOMI



QEVERIA REVOKON STATUSIN E NJË  
INVESTITORI STRATEGJIK, KOMPANIA  
E PAINFORMUAR **F.8**

BIE ÇMIMI I NAFTËS NË TREGUN  
NDËRKOMBËTAR **F.8**

### SPORT



MURIOI, 'MBRET' NË LA LIGA PËR  
DUELET NË AJËR **F.10**

## Shefi i NATO-s zbret në Ukrainë për ta shprehur mbështetjen e aleancës

**KIEV, 20 PRILL** - Shefi i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), Jens Stoltenberg, ka vizituar të enjten kryeqytetin e Ukrainës, Kievin, për herë të parë që nga nisja e pushtimit rus. Ai përmes kësaj vizite tregoi mbështetjen e aleancës ushtarake për Ukrainën derisa ajo po përgatitet për të nisur një kundërofensivë ndaj forcave ruse.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha në Kiev se prioriteti i aleancës është të sigurojë që Ukraina të "triumfojë" në luftën kundër Rusisë dhe se një plan anëtarësimi për Kievin do të diskutohet në një samit në korrik. "E ardhmja e Ukrainës është në familjen euroatlantike, e ardhmja e Ukrainës është në NATO, të gjithë aleatët bien dakord për këtë", tha Stoltenbergu në një konferencë për shtyp në Kiev. Stoltenbergu tha se "çështja e anëtarësimi do të jetë në agjendë" në një samit të NATO-s që do të zhvillohet në korrik në Vilnius të Lituaniës.

Ndërsa presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy tha se ishte koha që NATO të merrte një vendim politik për ta ftuar Ukrainën që t'i bashkohet aleancës ushtarake dhe se Kievi dëshironte të dinte se kur do të ndodhte kjo. "Unë jam mirënjohës për ftesën për ta vizituar samitin, por është gjithashtu e rëndësishme që Ukraina ta marrë ftesën përkatëse", u tha ai gazetarëve.



"Nuk ka asnjë pengesë të vetme objektive për vendimin politik për ta ftuar Ukrainën në aleancë dhe tani, kur shumica e njerëzve në vendet e NATO-s dhe shumica e ukrainasve mbështet anëtarësimin në NATO, është koha për vendimet përkatëse", tha Zelenskyy. "Ne e interpretojmë këtë vizitë të sekretarit të përgjithshëm, të

parën e luftës në shkallë të gjerë, si një shenjë se aleanca është e gatshme të fillojë një kapitull të ri në marrëdhëniet me Ukrainën, kapitullin e vendimit ambicioz", tha Zelenskyy.

Gjatë vizitës Stoltenbergu vendosi një kurorë për t'i nderuar ushtarët ukrainas që janë vrarë gjatë luftimeve në lindje të vendit dhe vizitoi vendin ku gjenden

automjetet e blinduara ruse të shkatërruara forcat ukrainase në kryeqytet. Ai filloi udhëtimin e tij të paparalajmëruar në një moment jetik në pushtimin pothuajse 14-mujor të Rusisë, i cili ka vrarë mijëra, larguar miliona, shkatërruar qytete dhe shkatërruar ekonominë ukrainase. Pasi Ukraina përballoi një ofensivë ruse gjatë dimrit dhe

pranverës, tani shpreson ta rimarrë tokën në jug dhe lindje të saj në një kundërofensivë në javët ose muajt e ardhshëm. Pasi i bëri nderimet e tij për ushtarët ukrainas, sekretari i përgjithshëm i NATO-s hipi në një makinë dhe u largua pas ngjarjes, raporton "Reuters". Pas mbërritjes së sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenbergu në Ukrainë, Rusia përsëriti qëndrimin e saj kundër anëtarësimi të Ukrainës në NATO.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha të enjten, siç raportohet nga agjencia ruse e lajmeve "Interfax", se Rusia e sheh veten të kërcënuar nga anëtarësimi i mundshëm i Ukrainës në NATO derisa kritikoi Perëndimin për dhënien ndihmë ushtarake Ukrainës. NATO-ja e ka mbështetur Ukrainën gjatë gjithë luftës, me shtetë anëtare që dërgojnë armë, por jo trupa luftarake. Kievi ka bërë thirrje vazhdimisht për më shumë armë nga aleatët. Ukraina e sheh të ardhmen e saj në aleancën e NATO-s dhe shtatorin e kaluar njoftoi për një kërkesë për anëtarësim të shpejtë pasi Kremlini tha se kishte aneksuar përjetësisht katër rajone ukrainase.

Moska e konsideron NATO-n si një bllok ushtarak armiqësor, i prirë për të cenuar atë që e sheh si sferën e saj të ndikimit. Ukraina fitoi pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik, i udhëhequr nga Rusia në vitin 1991.

## Zvicra e sanksionon grupin rus Wagner

**BERN, 20 PRILL** - Zvicra e ka sanksionuar të enjten grupin rus Wagner, duke ndjekur hapin e Bashkimit Evropian, i cili e ka bërë të njëjtën gjë një javë më parë.

Forcat e Wagnerit janë në krye të ofensivave në lindje të Ukrainës, përfshirë luftimet në qytetin e Bahmutit, ku po shënohen përlëshjet më të përgjakshme, prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, në shkurt të vitit të kaluar. "Grupi Wagner është organizatë ushtarake me bazë në Rusi, nën udhëheqësinë e Yevgeny Prigozhin, e cila shërben si instrument i luftës hibride të Rusisë", ka thënë Ministria ruse e Ekonomisë. "Ndonëse natyra e saj ligjore është e paqartë, grupi Wagner është pjesë e një rrjeti kompleks të kompanive globale, të cilat janë të lidhura përmes strukturave të mbivendosura të pronësisë dhe rrjeteve logjistike", është thënë në deklaratë.

I udhëhequr nga biznesmeni i

lidhur me Kremlinin, Prigozhin, Wagner është themeluar më 2014. Ky grup është përfshirë në konfliktet në Afrikë, Amerikën Latine dhe Lindje të Mesme. Zvicra nuk është pjesë e Bashkimit Evropian, mirëpo u është bashkuar sanksioneve të bllokut evropian sa i përket Rusisë, prej nisjes së luftës. Pavarësisht prej presionit nga Kievi dhe aleatët, Zvicra vazhdon ta ruajë neutralitetin e saj. Berni ka refuzuar kërkesat e shteteve të tjera që armët zvicerane të rieksporohen në Ukrainë. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022. Presidenti rus, Vladimir Putin, e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



# Escobari thotë se do t'i njohin rezultatet e zgjedhjeve në veri

PRISHTINË, 20 PRILL - I dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, tha se Shtetet e Bashkuara do t'i njohin zgjedhjet e së dielës në veri të Kosovës edhe nëse Lista Serbe i bojkoton ato, duke thënë se bojkotimi nuk përcakton zgjedhjet. "Ne u kemi bërë thirrje dhe unë, personalisht, u kam kërkuar serbëve, Listës Serbe, që të marrin pjesë dhe të mos heqin dorë nga roli që kanë. Fakti që nuk marrin pjesë është vendimi i tyre, por këto parashikohen nga Kushtetuta. Ka vende të paplotësuara. Ka njerëz që nuk po marrin shërbime nga pushteti lokal sepse nuk ka pjesëmarrje. Pra, nëse këto zgjedhje janë të lira dhe të ndershme, që unë parashikoj të jenë, rezultati do të jetë legjitim nga këndvështrimi ynë", tha Escobari në një intervistë për shërbimin shqip

të "Zërit të Amerikës". Më 23 prill pritet të mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunave të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit si dhe zgjedhje të parakohshme për dy kuvendet komunale, në Zveçan dhe Leposaviq. Zgjedhjet do të mbahen pasi kryetarët e këtyre komunave, bashkë me serbë të tjerë, më 5 nëntor të vitit të kaluar dhanë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin për reregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe. Në garë për kryetar të këtyre komunave janë 11 kandidatë nga katër subjekte politike, prej të cilëve vetëm dy janë të komunitetit serb. Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, nuk ka aplikuar për të marrë pjesë në



këto zgjedhje. Escobari tha se shpreson që serbët në Kosovë të gjejnë një mënyrë të rikthehen në institucione.

Megjithatë, Escobari tha se bojkoti nuk duhet ta vonojë themelimin e Asociacionit. "Ai detyrim është i

menjëhershëm, është ekzistues. Pavarësisht se kush është në pushtet, Asociacioni duhet të formohet", tha ai.

## KQZ-ja akrediton rreth 360 vëzhgues për zgjedhjet në veri

PRISHTINË, 20 PRILL - Rreth 360 është numri i vëzhguesve të akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për t'i vëzhguar zgjedhjet e së dielës, më 23 prill, që do të mbahen në katër komunat e veriut të Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj mbledhjeje KQZ-ja ka caktuar edhe vendotimet ku qytetarët do të mund të votojnë. Shefi i Sekretariatit të KQZ-së, Burim Ahmetaj, dha sqarime për procedurat e aplikimit për vëzhguesit. Ndërsa anëtari i PDK-së, Arianit Elshani, e pyeti se a është bërë transporti i kontejnerëve e ai u përgjigj: "Vendosja e kontejnerëve nuk mund të bëhet menjëherë, sepse janë 26. Është proces që nuk mund të kryhet brenda një dite për shkak se duhet bërë sistemimi". Sipas zëdhënësit të KQZ-së, Valmir Elezi, vëzhguesit e akredituar



përfaqësojnë subjekte të ndryshme politike, media, OJQ dhe përfaqësi të huaja diplomatike që janë të

akredituara në Kosovë. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve akreditoi 357 vëzhgues të cilët do të mund

ta përcjellin nga afër procesin zgjedhor më 23 prill dhe procedurat e tjera pas ditës së zgjedhjeve. Vëzhguesit e

akredituar përfaqësojnë subjekte politike, media, OJQ dhe përfaqësi të huaja që janë të vendosura në vendin tonë", njoftoi Elezi. Sipas tij, numri i vëzhguesve të akredituar në emër të subjekteve politike është gjithsej 75, ndërsa në emër të OJQ-ve të ndryshme do të vëzhgojnë 109 vëzhgues. Sipas të dhënave të publikuara nga KQZ-ja, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar është akredituar për t'i përcjellë këto zgjedhje me dy vëzhgues. Edhe mediet kanë shfaqur interesim të madh për këtë proces zgjedhor, pasi numri i përgjithshëm i tyre që janë akredituar është më shumë se 20 me më shumë se 170 persona. Në mesin e medieve që janë akredituar janë edhe mediet ndërkombëtare si Associated Press, Reuters, TRT Arabi, Al Jazeera Balkans e Anadolu Agency.

## Qeveria, pako të re mbështetëse për komunitetet joshumicë

PRISHTINË, 20 PRILL - Kryeministri Albin Kurti, zëvendëskryeministrja për Çështje të Pakicave dhe të Drejtat e Njeriut, Emilja Rexhepi, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ministri për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashqi dhe këshilltarja e kryeministrit për Çështje të Komuniteteve, Elizabeth Gowing, zhvilluan

të enjten një takim në të cilin diskutuan dhe u pajtuan për pakon e re mbështetëse për komunitetet joshumicë në vend. Kjo pako, që për fillim do të jetë në vlerë prej 3 milionë eurosh, përmban masa mbështetëse për: vende të reja të punës për bizneset ekzistuese dhe të reja; bujqit dhe prodhuesit e vegjël në zonat rurale; shoqërinë civile që

kontribuon në integrimin dhe afirmimin e komuniteteve joshumicë. Miratimi i saj pritet të bëhet në mbledhjen e radhës së qeverisë. Pakoja synon që përmes punësimit dhe prodhimit të kontribuojë drejtpërdrejt në zhvillimin, mirëqenien dhe integrimin sa më të plotë të komuniteteve joshumicë në Republikën e Kosovës.





# Arrestimi i drejtorit të KEK-ut përplas pozitën dhe opozitën në Kuvend

Deputetët e opozitës kanë kërkuar nga zyrtarët e qeverisë të japin më tepër informacione për arrestimin e drejtorit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Nagip Krasniqi, pasi, sipas tyre, ai ka qenë zyrtar i lartë i Lëvizjes Vetëvendosje. E kryeministri Albin Kurti tha se pati një gëzim opozitar për arrestimin e Nagip Krasniqit. “Ka pasur shumë kryeshefa në KEK në të kaluarën, ka pasur keqpërdorime marramendëse, por asnjëherë nuk janë trajtuar nga sistemi i drejtësisë, përkatësisht nga prokuroria”, ka thënë Kurti. Prokuroria Speciale ka kërkuar paraburgim për drejtorin e KEK-ut, i cili po dyshohet për tri vepra penale

Krasniqit. Por, ky është fakt i opozitës, nuk është fakt i çështjes. Ne e dimë që ka pasur shumë kryeshefa në KEK në të kaluarën, ka pasur keqpërdorime marramendëse, por asnjëherë nuk janë trajtuar nga sistemi i drejtësisë, përkatësisht nga prokuroria”, tha Kurti.

Shefi i ekzekutivit tha se ekziston një disponim negativ ndaj qeverisjes aktuale dhe ndaj pushtetit të dalë nga 14 shkurti. Kurti tërë këtë e lidhi edhe me figurën e prokurorit Blerim Isufaj. “Kjo lidhet me shumë se me askënd tjetër me figurën e prokurorit Blerim Isufaj. Bëhet fjalë për një prokuror që është i mirënjohur në skenën tonë publike. Që rastin e vrasjes së ish-shefit të AKP-së, Dino Hasanaj, e ka kategorizuar në vetëvrasje, ndërsa rastin e vetëvrasjes së ish-drejtorit të informimit në kryeministri, Hamdi Sopës, e shndërroi në vrasje. Po bëhet fjalë për një prokuror që asnjë rast s’e ka fituar në gjykatë dhe ky prokuror dëshiron të bëhet kryeprokuror...”, tha Kurti. Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, kërkoi nga ministrja e Ekonomisë t’i njoftojë deputetët se për çfarë

vlerash financiare dyshohet që ka abuzuar drejtori i KEK-ut. “Ne kemi parë që aty është bërë një abuzim jashtëzakonisht i madh, prej subvencionimit të tarifave, pastaj tenderët njëburimorë. Le të na tregojë sa është vlera e monetare e këtyre abuzimeve, e shumë e shumë çështje të tjera që lidhen me punësime. Sepse Nagip Krasniqi ka qenë zyrtar i lartë i partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, dhe ky zyrtar është arrestuar”, u shpreh Tahiri.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, para deputetëve tha se ende nuk ka informata zyrtare nga institucionet e drejtësisë për arrestimin e drejtorit të KEK-ut.

“Skandali i Nagip Krasniqit e bën përgjegjëse drejtpërdrejt qeverinë”, tha Hykmete Bajrami, deputete nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). “Për shkak se Nagip Krasniqi është eksponent i Lëvizjes Vetëvendosje, është personi që e ka shkruar programin për energji për këtë parti, si kryesues i Komisionit për Energjinë për Lëvizjen Vetëvendosje, ai e ka draftuar Strategjinë e Energjisë. Ai ka bërë që 15 muaj të merren vendime në këtë Kuvend, të

jemi në masa emergjente në mënyrë që të importojë energji dhe të bëhen tenderë të negociuar”, theksoi ajo.

Që nga vera e vitit të kaluar qeveria ka vendosur masa emergjente të energjisë për shkak të krizës energjetike të Kosovës.

Kurse kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, kërkoi nga qeveria që të ndërmarrë masa ndaj Nagip Krasniqit. “Kur dikush prej jush nuk ec si duhet, duhet t’ia tregoni vendin. Nuk besoj se është besnikëri të marrësh vendime të gabuara kundër interesit të vendit. E lus kryeministrin ta marrë anën e ligjit dhe drejtësisë”, tha ai.

Një ditë më parë kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka shkruar në “Facebook” për arrestimin e kryeshefit të KEK-ut, ish-drejtuessin e Komitetit për Energji në Lëvizjen Vetëvendosje, Nagip Krasniqi. Ai ka thënë se ky rast është dëshmia më e mirë e asaj që PDK-ja ka deklaruar për muaj të tërë se qeveria Kurti abuzimet më të mëdha i ka bërë pikërisht në sektorin e energjisë, përmes skemave korruptive dhe keqpërdorimit të pushtetit absolut që e kanë instaluar në këtë sektor.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Arrestimi i drejtorit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Nagip Krasniqi, ka përplasur pozitën dhe opozitën në seancën e Kuvendit të Kosovës të enjten.

Deputetë të opozitës kanë kërkuar nga zyrtarët e qeverisë të japin më tepër informacione për arrestimin e tij pasi, sipas tyre, Nagip Krasniqi ka qenë zyrtar i lartë i Lëvizjes Vetëvendosje.

Prokuroria Speciale e Kosovës

ka njoftuar se më 19 prill është arrestuar një person me inicialet N. K. nën dyshimet për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, ushtrim të ndikimit dhe konflikt interesi. Autoritetet e drejtësisë kanë njoftuar se N. K. është dërguar në mbajtje për 48 orë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se kjo çështje [arrestimi] ka fakte, me të cilat merret sistemi i drejtësisë dhe se nuk duhet “të zhvillohet gjyq në Kuvend për Nagip Krasniqin”. “Në anën tjetër, është fakt se pati një gëzim opozitar për arrestimin e Nagip

# Komisioni Evropian përshëndet nënshkrimin e liberalizimit të vizave për Kosovën

PRISHTINË, 20 PRILL - Komisioni Evropian ka përshëndetur nënshkrimin e vendimit për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës nga ana e Parlamentit Evropian dhe Këshilli. Anita Huper, zëdhënëse për çështje të brendshme në Komisionin Evropian, e quajti këtë lajm të mirë për qytetarët e Kosovës dhe realizim i aspiratave që u bë i mundur në bazë të propozimit të Komisionit. "Lëvizja pa viza për bartësit e pasaportave të Kosovës do të bëhet realitet më 1 janar 2024 më së voni. Pas pajtimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në bazë të propozimit të Komisionit Evropian, bartësit e pasaportave të Kosovës do të lejohen të udhëtojnë në Bashkimin Evropian pa viza për një qëndrim maksimal deri në 90 ditë në periudhën prej 180-ditësh" thuhet në një komunikatë të lëshuar nga Komisioni Evropian. "Lëvizja pa viza do të sjellë përfitime për qytetarët në të dyja anët, do t'i forcojë edhe më tutje raportet e BE-së me Kosovën. Kosova në vazhdimësi i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe kushtet dhe ka dëshmuar përkushtim në këtë drejtim", thuhet në këtë komunikatë. Në komunikatën e Komisionit



Evropian rikujtohet se që në vitin 2016 Komisioni i kishte propozuar Parlamentit dhe Këshillit t'u japë qytetarëve të Kosovës mundësinë e udhëtimit pa viza. Pastaj në vitin 2018 Komisioni kishte vlerësuar se

Kosova i kishte përmbushur të gjitha kërkesat nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave. Sipas procedurës së miratimit të vendimeve në BE, Komisioni është organ që bën vlerësime dhe rekomandime, ndërsa vendimet

në bazë të tyre merren bashkërisht nga Këshilli i BE-së dhe Parlamenti Evropian. Kështu ndodhi edhe me procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën për çka vendimi u nënshkrua më 19 prill nga

presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola dhe ministrja e Suedisë për Çështje të Bashkimit Evropian në emër të Këshillit. Tash pritet vetëm edhe botimi në gazetën zyrtare të BE-së dhe hyrja në fuqi e këtij vendimi.



"Abuzimet e qeverisë Kurti me tërë zinxhirin e sektorit të energjisë, prej prodhimit e deri te konsumi i saj, nuk janë as të rastësishme dhe as pa dashje", ka thënë Krasniqi. Lideri i PDK-së ka thënë se rritja e çmimit të energjisë elektrike

për mbi 100 për qind vitin e kaluar, rritja e dytë për 15 për qind para pak ditësh, pagesa në mënyrë jologjore e mbi 100 milionë eurove për faturat e serbëve në veri, bllokimi i ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese, si dhe shitja e lirë e

blerja e shtrenjtë e energjisë, lënë dyshime se janë pjesë e një piramide korruptive të krijuar nga qeveria Kurti e në krye të së cilës qëndron ambasadori me aktakuzë i Republikës së Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, i cili, sipas Krasniqit,

është boshti i aferës më të madhe korruptive rajonale të tregtimit të energjisë dhe shpëlarjes së parave. "Pas këtyre fakteve të reja, përkundër dëshmiave që i kanë dhënë në Komisionin Hetimor Parlamentar, tani po vërtetohen edhe takimet sekrete që kryeshefi ekzekutiv i KEK-ut, Nagip Krasniqi, i arrestuar sot, kishte muaj më parë me ambasadorin Martin Berishaj dhe tregtarë të tjerë të energjisë në Zagreb", ka thënë Krasniqi. Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se partia që drejton ka kërkuar në vazhdimësi shkakimin e gjithë udhëheqjes së KEK-ut, militantëve partiakë të vendosur nga partia në pushtet. "Pikërisht për shkak të një skandali si ky që kishte nisur në korrikun e vitit 2022. Ata gjetën mbrojtjen vetëm sepse ishin të partisë. Të njëjtët, pas dëmeve milionëshe ndaj vendit, ndodhen sot në pranga të policisë", ka thënë Abdixhiku. Ai ka theksuar se tani shkarkimi është i vonshëm. "Përgjegjësia politike për vendosjen, mbrojtjen dhe lejimin e përfitimeve milionëshe të mafisë energjetike është domosdoshmëri. Kjo përgjegjësi ka adresë qeverinë", është shprehur Abdixhiku. Korporata Energjetike e Kosovës është një ndër ndërmarrjet kryesore energjetike në vend. Asetet e korporatës janë nën pronësi të plotë të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

## Prokuroria Speciale kërkon paraburgim për drejtorin e KEK-ut, dyshohet për tri vepra penale

Prokuroria Speciale ka njoftuar të enjten se ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj drejtorit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi. Për të ekzistuar dyshimi i bazuar se ka kryer veprat penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", "Ushtrim i ndikimit" dhe "Konflikt i interesit". "Ju njoftojmë se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka bërë kërkesë për caktimin e paraburgimit pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, ndaj të pandehurit me inicialet N. K., për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar' nga neni 414, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, 'Ushtrimi i ndikimit', nga neni, 424 paragrafi 1 i KPRK-së, dhe veprën penale 'Konflikt i interesit', nga neni 417, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së", thuhet në njoftimin për medie.

MYFTIU I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS, NAIM TËRNAVA, I KA URUAR BESIMTARËT MYSLIMANË NË PRAG TË FESTËS SË FITËR BAJRAMIT

## Vendi ynë të bëhet vend ku jetohet e punohet me dinjitet

Myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, i ka uruar besimtarët myslimanë në prag të festës së Fitër Bajramit. Ai ka thënë se tash e sa kohë shtetin tonë e kemi realitet por, si qytetarë të këtij vendi, e kemi obligim ta bëjmë më të mirën për vendin tonë, ta bëjmë atë të jetueshëm për të gjitha kategoritë e shoqërisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 PRILL - Myftiu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim Tërnavë, i uroi besimtarët myslimanë në prag të festës së Fitër Bajramit. Fitër Bajrami është një nga festat kryesore të besimtarëve myslimanë dhe këtë vit festohet të premten, më 21 prill.

Myftiu Tërnavë në urimin e tij tha se Fitër Bajrami është festa më popullore që prek të gjitha shtresat dhe kategoritë e shoqërisë dhe që shënon përfundimin e muajit të Ramazanit. "Fitër Bajrami na vjen pas një muaji të mëshirës e sakrificës. Pas muajit të faljeve dhe begatave të veçanta që i sjell vetëm Ramazani", tha Tërnavë.

Ai tha se çdo qytetar duhet të punojë për ruajtjen e familjes si dhe të vendlindjes. "Ka dashtë Zoti që tash e sa vjet vendi ynë është i lirë e i pavarur, mirëpo është obligim yni që vendin tonë ta ndërtojmë e ta bëjmë me perspektivë, një vend ku

jetohet me dinjitet, ku fëmijët tanë rriten të sigurt e marrin edukim dhe arsimim cilësor, një vend ku sigurojmë vende pune e jetese të dinjitetshme. Dikur lirinë e vendit e kishim ide e projekt, ndërsa tani falë sakrificës shekullore të popullit, tash e sa kohë shtetin tonë e kemi realitet, por si qytetarë të këtij vendi e kemi obligim ta bëjmë më të mirën për vendin tonë, që ta bëjmë atë të jetueshëm për të gjitha kategoritë e shoqërisë", ka thënë Tërnavë.

Ai ka theksuar se braktisja e vendit nuk është zgjidhje e duhur, sidomos nga të rinjtë dhe ekspertët tanë. "Jeta në këtë botë nuk ka qëllim dhe mision vetëm anën materiale. Dashtë Zoti që vendi ynë, me angazhimin tonë, të bëhet vend ku jetohet e punohet me dinjitet", është shprehur myftiu Tërnavë.

Festa e Fitër Bajramit pason pas një muaji agjërimit që, sipas besimit islam, bëhet në shenjë sakrifice dhe përkushtimi ndaj Zotit.



## Konjufca: Kosova nuk e ka obligim formimin e Asociacionit pa njohje de facto

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 PRILL - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka shprehur skepticizëm se Kosova do të pranojë ndonjë version të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe deri më 2 maj kur pritet një takim i nivelit të lartë në Bruksel.

I dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, tha se pret që deri me këtë datë

Qeveria e Kosovës të ketë një propozim për Asociacionin. I pyetur nga gazetarët për këtë deklaratë, Konjufca tha se nuk përjashtohet mundësia që edhe propozimi i ri që do të bëjë grupi menaxhues të mos pranohet nga Kosova. "Nuk e përjashtoj se as ky tjetri [versioni i ri i Asociacionit] nuk do të funksionojë duke parë përbërjen e këtij ekipi të menaxhimit, që është i përbërë edhe nga deputetët të Serbisë. Kjo është e papranueshme për

Kosovën", ka deklaruar Konjufca. Ai ka shtuar se nëse propozimi është në interes të Serbisë, atëherë ekipi menaxhues, sipas tij, duhet të shkarkohet. Më tej Konjufca ka thënë se pret që të sqarohet situata më 2 maj, kur pritet të takohen kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. "Kosova duhet të tregojë se nuk ka kurrfarë obligimi dhe nuk duhet ta bëjë asnjë hap pa u realizuar binari i parë e që është njohja de facto [nga Serbia]", tha

Konjufca. Në prag të takimit të 2 majit në mes të Kurtit dhe Vuçiqit, i dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, tha për "Zërin e Amerikës" se që nga takimi i 18 marsit që është zhvilluar në Ohër të Maqedonisë së Veriut, ka pasur përparim lidhur me Asociacionin dhe një evoluim të jashtëzakonshëm në qëndrimin e Qeverisë së Kosovës, në veçanti të kryeministrit Albin Kurti, për të pranuar këtë detyrim ligjor. Kosova

dhe Serbia kanë nënshkruar marrëveshjen për formimin e Asociacionit në vitin 2013 dhe më pas për parimet e tij më 2015. Më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar që shumica e parimeve të marrëveshjes nuk janë në përputhje me Kushtetutën, por që mund të harmonizohen. Megjithatë, Qeveria e Kosovës e ka refuzuar formimin e asociacioneve njëetnike, duke thënë se mund ta dëmtojnë funksionalitetin e Kosovës.

# Çfarë po ndodh në Sudan?



**KHARTUM, 20 PRILL** - Luftimet kanë shpërthyer në Khartum dhe zona të tjera të Sudanit, pas një beteje mes dy fraksioneve të fuqishme rivale ushtarake. Është hera e parë që kryeqyteti përfshihet në luftë dhe rreziku për një konflikt civil mbarëkombëtar po shtohet.

## Çfarë e shkaktoi dhunën?

Prej muajsh po shkallëzohet tensioni në mes të ushtrisë sudaneze dhe Forcave paraushtarake të Mbështetjes së Shpejtë (RSF), të cilat së bashku rrëzuan një qeveri civile në një grusht-shteti të tetorit 2021. Situata arriti kulmin për shkak të një afati të një plani të mbështetur nga ndërkombëtarët për të filluar një tranzicion të ri për kontrollin civil mbi forcat ushtarake. Një marrëveshje përfundimtare ishte parashikuar të nënshkruhej në fillim të prillit, katër vjet pas përmbyesjes së autokratit Omar al-Bashir përmes një kryengritjeje popullore. Si ushtrisë ashtu edhe RSF-së iu kërkua ta dorëzonin pushtetin sipas planit dhe dy çështje rezultuan veçanërisht të

vështira: njëra ishte afati kohor për integrimin e RSF-së në forcat e armatosura, e dyta ishte që ushtria do të vihej zyrtarisht nën kontrollin civil. Kur shpërthyen luftimet më 15 prill, të dyja palët e fajësuan njëra-tjetrën për provokimin e dhunës. Ushtria akuzoi RSF-në për mobilizim të paligjshëm dhe RSF-ja, ndërsa përparonte në zona strategjike në Khartum, tha se ushtria ishte përpjekur të merrte kontroll të plotë në një komplot me besnikët e Bashirit.

## Kush janë "lojtarët" kryesorë në terren?

Protagonistët në luftën për pushtet janë gjenerali Abdel Fattah al-Burhan, kreu i ushtrisë dhe udhëheqësi i këshillit qeverisës të Sudanit që nga viti 2019, dhe zëvendësi i tij në këshill, kreu i RSF-së, gjenerali Mohamed Hamdan Dagalo, i njohur si Hemedti. Ndërsa zhvillohej plani për tranzicionin, Hemedti anoi kah partitë civile të një koalicioni, Forcat për Liri dhe Ndryshim (FFC), që ndante pushtetin me ushtrinë në periudhën mes përmbyesjes së Bashirit dhe grushtit të shtetit të vitit 2021. Diplomatët dhe analistët thanë se kjo ishte pjesë e një strategjie

të Hemedtit për ta shndërruar veten në një burrë shteti. Si FFC-ja ashtu edhe Hemedti, të cilët u pasuruan përmes minierave të arit dhe sipërmarrjeve të tjera, theksuan nevojën për t'i mënjanuar besnikët dhe veteranët e ish-udhëheqësit Bashiri me prirje islamike, të cilët kishin rifituar terren pas grushtit të shtetit dhe kanë rrënjë të thella në ushtri. Së bashku me disa fraksione rebele pro-ushtrisë që përfituan nga një marrëveshje paqeje e vitit 2020, besnikët e Bashirit kundërshtuan marrëveshjen për një tranzicion të ri.

## Çfarë rrezikohet?

Kryengritja popullore kishte rritur shpresat se Sudani dhe popullsia e tij prej 46 milionësh mund të dilnin nga një periudhë disadekadashe autokracie, konflikti të brendshëm dhe izolimi ekonomik nën Bashirin. Luftimet aktuale jo vetëm që mund të shkatërrojnë këto shpresa, por të destabilizojnë një rajon të paqëndrueshëm në kufi me Sahelin, Detin e Kuq dhe Bririn e Afrikës. Situata mund të bëhet gjithashtu pre e konkurrencës për ndikim në rajon midis Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara dhe midis fuqive rajonale.

## Cili është roli i aktorëve ndërkombëtarë?

Fuqitë perëndimore, përfshirë Shtetet e Bashkuara, kishin mbështetur tranzicionin drejt zgjedhjeve demokratike pas përmbyesjes së Bashirit. Ato pezulluan mbështetjen financiare pas grushtit të shtetit dhe më pas mbështetën planin për një tranzicion të ri dhe një qeveri civile. Fuqitë e pasura me energji, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë kërkuar gjithashtu të ndikojnë tek ngjarjet në Sudan, duke e parë largimin nga pushteti të Bashirit si një mënyrë për të rikthyer ndikimin islamik dhe për të forcuar stabilitetin në rajon. Shtetet e Gjirit janë përpjekur të bëjnë investime në sektorë si bujqësia ku Sudani ka potencial të madh, dhe portet në bregun e Detit të Kuq të Sudanit. Rusia ka kërkuar të ndërtojë një bazë detare në Detin e Kuq, ndërkohë që disa kompani të Emirateve të Bashkuara Arabe janë angazhuar të investojnë. Si Burhan edhe Hemedti krijuan lidhje të ngushta me Arabinë Saudite, pasi dërguan trupa për të marrë pjesë në operacionin e udhëhequr nga Arabia Saudite në Jemen. Hemedti ka vendosur marrëdhënie me fuqi të tjera të

huaja, përfshirë Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Rusinë.

## Cilët janë skenarët?

Palët ndërkombëtare kanë bërë thirrje për armëpushim humanitar dhe një kthim në dialog, por ka pasur pak shenja kompromisi nga fraksionet ndërluftuese. Ushtria e ka quajtur RSF-në një forcë rebele dhe ka kërkuar shpërbërjen e saj, ndërsa Hemedti e ka quajtur Burhanin kriminel dhe e ka fajësuar atë për shkatërrimin e vendit. Megjithëse ushtria e Sudanit ka më shumë burime, përfshirë fuqinë ajrore dhe rreth 300 000 trupa, RSF-ja është zgjeruar në një forcë prej të paktën 100 000 trupash që janë vendosur në të gjithë Khartumin dhe qytetet fqinje, si dhe në rajone të tjera, duke ngjallur frikën e një konflikti të stërzgjatur, përveç një krize ekonomike afatgjatë dhe nevojave ekzistuese humanitare në shkallë të gjerë. RSF-ja mund të përfitojë nga mbështetja dhe lidhjet fisnore në rajonin perëndimor të Darfurit, duke qenë se i pati fillesat nga milicitë që luftuan së bashku me forcat qeveritare për të shtypur rebelët në një luftë brutale që u përshkallëzua pas vitit 2003. (voa)


## Murati përplaset me opozitën lidhur me Projektligjin për Tatimin në Pronë

PRISHTINË, 20 PRILL - Miratimi në Komisionin për Buxhet i Projektligjit për Tatimin në Pronë, ku qytetarëve do t'u falen 100 euro nga faturat, ka nxitur përplasje në Kuvendin e Kosovës.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, kërkoi nga kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Financave, Hekuran Murati, të tregojnë se pse e kanë marrë këtë vendim. "A ka mundësi me na tregu pse po doni mi bankrotu komunat me Ligjin për Faljen e Tatimit në Pronë. 40 për qind të buxhetit të

vitit të ardhshëm për të hyra vetjake po dëshironi me ua humb. Po ju duket qesharake. Është turp që po qeshni. A është synim politik me i bankrotu komunat apo çka? Nëse doni me fal tatimin në pronë, subvencion", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se "nëse është vendim politik ne do t'i përdorim të gjitha mekanizmat për t'i ndalë këto". Pas kësaj është përgjigjur ministri Hekuran Murati. Murati ka thënë se Projektligji për Tatimin në Pronë ka ardhur si rezultat i kërkesës nga ky parlament. "Ka

qenë pikërisht opozita që ka kërkuar të lehtësohet barra e qytetarëve sa i përket Tatimit në Pronë. Pas diskutimeve që kemi pasur në Komisionin për Buxhet, ka ardhur ky projektligj. Kërkesa dhe propozimi për faljen deri në 100 euro të faturave të secilit qytetar ka rrjedhë pas diskutimeve që janë ngritur nga deputetët opozitarë", ka thënë Murati. Ministri shtoi se nuk është synimi që të bankrotojnë komunat, përkundrazi për vitin e ardhshëm parashihet rritje e buxhetit për komunat.



## Qeveria revokon statusin e një investitori strategjik, kompania e painformuar

PRISHTINË, 20 PRILL - Përfaqësues të kompanisë "Moxico Luma Kosova Mining" i thanë "Radios Evropa e Lirë" se nuk kanë asnjë informacion zyrtar nga Qeveria e Kosovës lidhur me shfuqizimin e vendimit për dhënien e statusit të investitorit strategjik kësaj kompanie. "Ne mbetemi me shpresë që komunikimi me qeverinë do të vazhdojë me qëllim të zbatimit të investimit tonë në Kosovë", thuhet në një përgjigje me shkrim dërguar "Radios Evropa e Lirë" nga kjo kompani.

Më 18 prill Qeveria e Kosovës përmes një komunikate për medie njoftoi se ka shfuqizuar vendimin e datës 13 dhjetor 2022 me të cilin ishte konfirmuar vullneti i qeverisë për t'i proceduar Kuvendit vendimin për dhënien e statusit investitor strategjik për kompaninë "Moxico Luma Kosova Mining". Në Qeverinë e Kosovës i kanë thënë "Radios Evropa e Lirë" se ky veprim është mbështetur në Ligjin për Investime Strategjike që, sipas tyre, i mundëson ekzekutivit të ndërmarë masa të revokimit për dhënien e statusit të projektit strategjik. Kjo, sipas qeverisë, mund të bëhet edhe



përgjatë përgatitjeve apo edhe zbatimit të projektit investues. Vendimi, sipas qeverisë, është marrë duke iu referuar nenit 14, pika e parë e Ligjit për Investime Strategjike. Në nenin

14 të këtij ligji thuhet: "Në rast se përgjatë përgatitjeve dhe zbatimit të projektit investues strategjik, Komisioni merr dëshmi të reja në bazë të të cilave konstaton dhe vërteton

se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për dhënien e statusit të investimit strategjik,

qeveria e revokon vendimin për dhënien e statusit investim strategjik".

Ligji për Investime Strategjike ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2017. Sipas këtij ligji, vëllimi i investimit për ta fituar statusin e investimit strategjik është nga 10 deri në 30 milionë euro, varësisht nga sektori. Prioritet në përzgjedhjen e projekteve për ta fituar statusin e investimit strategjik, sipas këtij ligji, u jepet projekteve me vëllim më të madh investimesh dhe të cilat gjenerojnë më shumë vende pune. Projekti i kompanisë "Moxico Luma Kosova Mining" përfshinte eksplorimin dhe verifikimin e burimeve minerale.

Kapitali i investimit strategjik ishte mbi 45 milionë euro, ndërsa investimi do të realizohej në fshatrat Gumnishtë, Vllahi dhe Karaqë të komunës Mitrovicë dhe Vushtrri. Në këtë projekt ishte paraparë të punësoheshin 300 punëtorë.

Investimet e huaja në Kosovë, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, në periudhën janar - tetor 2002 kapnin vlerën e mbi 600 milionë euro.

## Bie çmimi i naftës në tregun ndërkombëtar

PRISHTINË, 20 PRILL - Çmimet e naftës kanë rënë nën 84 dollarë në tregjet ndërkombëtare, nën presionin e sinjaleve nga Banka Qendrore amerikane se do t'i rrisë sërish normat e interesit, gjë që mund ta ngadalësojë ekonominë dhe konsumin e naftës. Në tregun e Londrës çmimi i një fuçie të enjten ishte 1.34 dollarë më i ulët se në mbylljen e një dite më parë dhe arriti në 83.43 dollarë. Në tregun amerikan një fuçi u tregtua me një çmim më të ulët prej 1.28 dollarësh, nga 79.58 dollarë. Në fokus të tregtarëve të mërkurën ishte

edhe politika monetare amerikane. Kreu i zyrës së Bankës Qendrore amerikane në Atlanta, Raphael Bostic, tha të martën se ka të ngjarë t'i rrisë edhe një herë normat e interesit për ta frenuar inflacionin. Tregjet po spekulojnë se FED do t'i rrisë ato me një çerek pikë përqindjeje në muajin maj, duke i vendosur shanset për një lëvizjeje të tillë në 85 për qind. Zyrtarët e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) monitorojnë nga afër inflacionin dhe sinjalizojnë se duhet të vazhdojnë t'i rritin

normat e interesit në eurozonë. Frika se kostot më të larta të huamarrjes do ta ngadalësojnë ekonominë dhe kërkesën për naftë u lanë në hije nga të dhënat për rritjen e fortë të ekonomisë kineze në tremujorin e parë, me 4.5 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe rafinimin rekord të naftës në mars.

Tregtarët, gjithashtu, injoruan rënien e rezervave të naftës së papërpunuar në ShBA, me rreth 2.68 milionë fuçi, sipas burimeve që citojnë të dhëna nga Instituti Amerikan i Naftës (API). Rënie kanë shënuar




edhe rezervat e benzinës dhe derivateve, thonë ata. Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEC)

njoftoi veçmas se të martën çmimi i një fuçie të shportës së naftës të anëtarëve të saj ra 92 centë, në 85.51 dollarë.



# Zoti i Kohës – Të menduarit mbi vdekjen të ndihmon ta jetosh më mirë jetën



Nga Oliver BATEMAN

Në filmin klasik të Xhon Hjuston, *Beat the Devil* (Të mposhtësh Djallin), aktori Piter Lor bën një diskutim të përmbledhur mbi natyrën e kohës: “Çfarë është koha? Zvicëranët e prodhojnë. Francezët e grumbullojnë. Italianët e shpërdorojnë. Amerikanët thonë se koha është para. Hindutë thonë se ajo nuk ekziston. A e dini se çfarë mendoj? Unë them se koha është një mashtruese”.

Në fakt Lor ka deri diku të drejtë mbi natyrën iluzive të kohës. Me çdo sekondë që kalon, ne e humbasim atë. Ata që janë të mbingarkuar nga përgjegjësitë – unë ju, gjithë të tjerët – mund të thonë se po u “vidhet koha”. Dhe pikërisht në këtë lumë të rrjedhshëm të kohës së humbur, shkrimtarja dhe artistja Xheni Odëll, autore e librit “Si të mos bësh asgjë: Rezistenca ndaj ekonomisë së vëmendjes” të vitit 2019, vjen së fundmi me një këshillë të re mbi kursimin e ri të kohës: Zbuloni një jetë përtej orës.

Duke qenë një historian në profesion, e di se vetmja gjë që nuk e bën historia, për mirë a keqcoftë, është të përsëritet. Ajo që kam kërkuar unë është diçka që nuk do ta kem kurrë: më shumë kohë. Jo kohë më të mirë dhe as më kuptimplote, siç propozon Odëll në librin e saj të fundit, por thjesht

më shumë kohë sa i përket sasisë. Sepse ndërsa nuk dua të jetoj përgjithmonë, shpresoj të jetoj mjaftueshëm për të bërë gjithçka që jam zotuar të bëj. Si për shembull të ndihmoj vajzën time të kalojë në moshën madhore dhe të kujdesem prindërit por edhe bashkëshorten time në pleqëri.

Odëll e nis librin me një mënyrë shumë premtuese. Rreshti hapës “Asgjë nuk është më e vështirë sa të bësh asgjë”. Por shumë shpejt bëhet e qartë se Odëll, një person pa dyshim i privilegjuar që ka pasur shumë kohë të lirë gjatë studimeve të saj akademike, nuk ka asgjë për të më ofruar mua, një njeri që ka punuar 40 orë në javë që nga ditëlindja e tij e 16-të.

Odëll shëtit vazhdimisht në natyrë dhe është e njohur me të gjithë analizat shqetësuese mbi vdekjen për shkak të ngrohjes planetare. Ajo e shfrytëzon rastin për ta vendosur emergjencën e klimës në një diskutim mbi mënyrat se si grekët e lashtë përcaktonin kohën: Chronos – koha si një lloj përparimi linear përpara – dhe Kairos – një “krizë” ose ndërprerje në kohë.

Ne të gjithë jetojmë në një kohë lineare, por përjetojmë kujtime – përmblyje dhe zi buke – të krizave të përhershme ku jemi gjendur. Që nga shfaqja e qytetërimit, njerëzit e kanë perceptuar gjithmonë veten si duke jetuar në një kohë të huazuar. Dhe kjo është e vërtetë sepse thotë

J.R.R. Tolkien ne jemi gjithmonë “njerëz të vdekshëm, që jemi të dënuar të vdesim”. Është qasja ndaj vdekshmërisë, ajo që ndan veprën e Odëll “Katër mijë javët” e Oliver Burkeman, një titull që i referohet jetëgjatësisë mesatare të njeriut.

Odëll, ateiste, është e shqetësuar me dëmtimin e klimës në të gjithë ekosistemin. Burkeman, kulturalisht hebre, është i shqetësuar mbi përpjekjen për të pasur një jetë të ekuilibruar dhe të moderuar në sasinë e kohës që na është caktuar këtu në Tokë. Dhe është pikëpamja e këtij tëfundit, ajo që më ka tërhequr gjithmonë.

Toka mund të ketë fund, por për ne që jemi rritur me çdo gjë që i ngjan një botëkuptimi koherent fetar, dhe që tani po përpiqemi të krijojmë një familje, gjithçka ka marrë fundtashmë. Kur im atë ishte shtirë në shtratin e vdekjes – vdiq në shtratin e tij në shtëpi – më tha se gjithmonë e kishte menduar se ishte më e lehtë të vdiste së bashku me miliona të tjerë gjatë përplasjes së një meteori me Tokën apo një nëndetëse të Luftës së Dytë Botërore, sepse ajo nuk ofronte asnjë premtim për një vdekje

kolektive që do të shërbente për një sagë të madhe heroike.

Siç e pranon edhe Odëll, sot jemi të bombarduar me alarme të përditshme për një krizë apo tjetrën. Pra kërkohet një akt vullneti për të na kujtuar se vdekja e dikujt, nuk është një ngjarje aq domethënëse, sa të përkojë me fundin e jetës siç e njohim ne. Ajo do të përkojë vetëm me fundin e jetës siç e njohim tani.

Prandaj është e çuditshme që Odëll citon filozofin katolik Zhozef Piper, sipas të cilit përgatitja për vdekjen qëndron pas gjithçkaje të shkruar aty. Për Piperin e devotshëm fetarisht, por edhe si për filozofin danez Soren Kierkegard, jeta është një përgatitje për përjetësinë.

Unë e kuptoj se si koha, sipas historianit Fernand Braudel, kalon ngadalë si për strukturat e palëkundura të shoqërisë, ashtu edhe për individë si unë. Por më e rëndësishmja, në një mënyrë që asnjë prej këtyre librave nuk e thekson në kohë, unë e di që do të vdes.

Babai dhe nëna ime nuk pushuan kurrë me këto kujtime, të cilat u bënë jehonë atyre të Epiktetit: “Çfarë dëmi është kur puth fëmijën tënd të vogël dhe t’i thuash: Nesër do të vdesësh?”. Kur nëna ime dhe unë lexonim “The Phantom Tollbooth” të Norton Juster – libri im i preferuar në vitet e para të shkollimit tim – ne do të

zgjateshim gjatë pasazheve mbi kohën.

Libri përshkruante në mënyrë të shkëlqyer mënyrat se si e humbim kohën, Ai thoshte se kemi aq kohë sa do të na jepet: “Koha është një dhuratë, që ju jepet për t’ju dhënë kohën që ju nevojitet”. Ose siç shprehet Kierkegard: “Të mbarosh punë me jetën para se jeta të ketë mbaruar me ty, do të thotë pikërisht të mos kesh mbaruar detyrën”.

Për ata nga ne që i kanë parë tashmë të vdesin prindërit tanë dhe shumë nga të afërmit tanë të afërt – sidomos për njerëzit si unë, që nuk ndajnë besimin e Pieper dhe Kierkegard mbi përjetësinë – ky është një ngushëllim i vakët. Megjithatë mbetet një ngushëllim. Ne jemi duke pasur parasysh kohën që na duhet për të pasur kohën e jetës sonë, dhe jo më shumë.

Siç shprehet filozofi gjerman Martin Heidegger, jetët tona përkufizohen nga “fundësia”.

Ne ekzistojmë në një gjendje “ të qenit-drejt-vdekjes”: një gjendje magjepsëse, qoftë vetëm për ne personalisht apo për familjet dhe miqtë tanë, që do të zgjasë derisa të marrë fund ajo. Nuk ka asnjë mënyrë për të blerë më shumë kohë, për të humbur kohë dhe madje në analizën përfundimtare as për ta kursyer atë. Ju do të merrni aq kohë sa do t’iu jepet. / “Unherd” – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Muriqi, 'mbret' në La Liga për duelet në ajër

Mallorca, 20 prill - Vedat Muriqi është duke e kaluar një sezon fantastik me skuadrën e Mallorcas. Sulmuesi "dardan" ka realizuar 12 gola dhe i ka bërë dy asistime deri tash në La Liga. Por, "Pirati" e mban një primat në ligën elitare

spanjolle. Më saktësisht, 28-vjeçari po prin në garën e dyluftimeve në ajër. Përfaqësuesi kosovar i ka fituar 16 duele në ajër brenda një ndeshjeje, respektivisht në duel me Celta Vigon, një rekord absolut ky për këtë

sezon. Kësaj arritjeje i është gëzuar edhe Mallorca, e cila e ka bërë një postim duke shkruar: "Fluturon 'Pirati'. Rekord në La Liga". Muriqi njihet për aftësitë e tij në lojën në ajër falë gjatësisë dhe shkëputjes.



## Çeku: Delegacioni i UEFA-s dhe i FIFA-s erdhi për diçka tjetër, s'pati vërejtje rreth moslicencimit të FFK-së

PRISHTINË, 20 PRILL - Vizita e para pak ditëve e një delegacioni të UEFA-s dhe FIFA-s në Kosovë nuk e kishte prioritet kryesor procesin e licencimit të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) nga ana e Ministrisë së Sportit, proces që vazhdon të mbetet ende i papërfunduar. Sipas ministrit të Sportit, Hajrulla Çeku, tema e moslicencimit të FFK-së ishte e dyta për nga rëndësia. Sipas ministrit, ardhja e mysafirëve nga UEFA dhe FIFA kishte të bënte kryesisht me hetimet që Njësia Policore Kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit po i zhvillon në FFK, respektivisht mbi drejtuesit e saj, me ç'rast kryetari Agim Ademi për gati një muaj ishte në arrest shtëpiak, kurse zyrtarë të tjerë të lartë janë intervistuar nga policia e cila po i vazhdon hetimet. "Vizita e tyre kishte të bënte kryesisht me situatën e fundit në lidhje me procesin që po zhvillohet ndaj kryetarit të

Federatës, zotëri Ademi", ka thënë ministri Çeku në një emision televiziv në ATV. Madje ministri Çeku ka treguar se zyrtarët e UEFA-s dhe të FIFA-s nuk kishin kurrfarë vërejtjeje apo kundërshtim në procesin ministror të licencimit të FFK-së. "Njëkohësisht pjesë e agjendës së tyre ka qenë edhe informimi në lidhje me procesin e licencimit të FFK-së. Unë e kam pritur këtë delegacion në zyrën time. I kam ofruar hollësi rreth këtij procesi dhe, natyrisht, ata kanë qenë shumë dakord me mënyrën qysh po zhvillohet ky proces. Nuk është asgjë jashtë parimeve që ata vetë i promovojnë kur fitet për integritet dhe qeverisje të mirë sportive brenda organizatave", tregoi Çeku. Para vizitës në Ministrinë e Sportit, delegacioni i UEFA-s dhe i FIFA-s e kishte vizituar FFK-në, ku ishte pritur nga nënkryetari Bakir Burri dhe



sekretari Taulant Hodaj, në mungesë të kryetarit Agim Ademi që ishte në arrest shtëpiak. FFK-ja në komunikatë vizitën e këtij

delegacioni e kishte lidhur vetëm me temën rreth moslicencimit të FFK-së nga Ministria e Sportit. "Delegacioni i përbashkët i

UEFA-s dhe FIFA-s po qëndron sot për vizitë të jashtëzakonshme në Kosovë, për t'u njoftuar nga afër me zhvillimet e fundit rreth FFK-së, procesin e licencimit nga MKRS-ja dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohen klubet e futbollit. Delegacioni fillimisht u takua me nënkryetarin Bakir Burri dhe sekretarin e përgjithshëm, Taulant Hodaj, derisa më pas zhvilluan një takim të përbashkët edhe me përfaqësuesit e klubeve, për të diskutuar shqetësimet e këtyre të fundit në lidhje me procesin e licencimit dhe vështirësitë që po i hasin gjatë këtij procesi. Përfaqësuesit e UEFA-s dhe FIFA-s i dëgjuan me vëmendje të gjitha shqetësimet e ngritura nga përfaqësuesit e klubeve, premtuan se do t'i adresojnë ato në organet kompetente dhe me angazhimin e përbashkët të të gjitha palëve shumë shpejt mund të ketë rezultate pozitive në këtë drejtim", thuhej në njoftimin e FFK-së më 17 prill.

## KV Drita me rikthim sensacional fiton Kupën



GJILAN, 20 PRILL - KV Drita ka ripërsëritur suksesin e vitit të kaluar në Kupën e Kosovës në volejboll, madje në rrethana të njëjta, duke e mposhtur me përmbyseje në një finale spektakolare në sallën "1 Tetori", skuadrën e Fer Volleyn. Ishte reprizë e finales së kaluar e këtij kompeticioni, me Dritën që triumfoi me rezultat 3-2 (18:25, 22:25, 25:23, 25:18, 15:13), njëjtë si

një vit më parë. Fer Volley po avanconte 2-0 pas dy seteve të para falë një performace të fortë. Megjithatë, Drita arriti ta ripërsërisë suksesin duke përmbystur rezultatin me një paraqitje sensacionale në tre setet pasuese. Kupën për "Intelektualet" e dha presidenti i Federatës së Volejbollit të Kosovës (FVK), Bahri Gjinovci. Nënkrjetarja e FVK-së, Mimoza Shkodra

Bislimi dhe sekretari i përgjithshëm, Valon Nikqi, ndan medaljet për kampionet. Medaljet për vendin e dytë u dhanë nga anëtari i bordit, Gazmend Husaj dhe drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Gjilan, Kushtrim Zeqiri. Çmimin MVP, të cilin e fitoi Megi Bislimi, e dha trajneri i Kombëtares U17 dhe legjenda e volejbollit, Donald Suxho.

## Rrahmani mungon ndaj Juves

Napoli, 20 prill - Mbrojtësi i 'napolitanëve', Amir Rrahmani, nuk do të luajë kundër Juventusit. Napoli dhe Juve do të ndeshen këtë fundjavë në kuadër të elitës

së futbollit tonë. Reprzetuesi i Kosovës nuk do të luajë kundër torinezëve pas lëndimit që pësoi në sfidën kundër Milanit, ndeshje kjo e

zhvilluar në kuadër të Ligës së Kampionëve. Rrahmani, siç raportohet, ka një lodhje muskulore dhe nuk pritet të kthehet në ndeshjen e radhës. Kapiteni i

Kombëtares së Kosovës ka bërë një sezon të madh dhe tashmë është një nga lojtarët kryesorë në skuadrën e Luciano Sapllëtit.



## Guardiola: Nëse duam ta fitojmë Ligën e Kampionëve duhet ta quajmë veten 'Real Madrid'

MANCHESTER, 20 PRILL - Pasi e eliminoi Bayern Munchenin, trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, do të luajë gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. City do të

ndeshet me Real Madridin në gjysmëfinale, skuadrën që e privoi nga finalja e vitit të kaluar. Për këtë fakt, Guardiola është i vetëdijshëm dhe e ka vlerësuar shumë lart rivalin e tij në

gjysmëfinale. Ai tha se nëse një skuadër dëshiron ta fitojë Ligën e Kampionëve duhet ta quajë veten "Real Madrid". "Të gjitha skuadrat kanë ndjenjën se nëse doni ta fitoni Ligën e

Kampionëve, duhet ta quani veten Real Madrid. Më parë ishte Barça, tani është Madridi. Real Madridi ka qenë në njëmbëdhjetë gjysmëfinale në 13 vjet. Ne kemi qenë në tri.



## Barça, plan të hollësishëm për rikthimin e Messit

BARCELONË, 20 PRILL - Barcelona dëshiron ta rikthejë Lionel Messin në "Camp Nou" dhe vetë sulmuesi argjentinas dëshiron ta veshë sërish fanellën blaugrana. Këtë e ka nënvizuar gazeta spanjolle "Sport", e cila analizon mënyrën sesi kampioni argjentinas mund të kthehet në "shtëpi". Barcelona është duke studiuar opsionet për ta mundësuar regjistrimin e tij në La Liga. Në këtë kuptim klubi tashmë ka kryer hetimet dhe është i bindur se mund ta arrijë objektivin. La Liga do ta miratonte nënshkrimin e Messit nëse argjentinas do të pranonte të fitonte rreth 25 milionë euro bruto në sezon, katër herë më pak sesa fitonte kur u largua nga Barcelona më 2021. Paga neto e Messit do të shkonte në rreth 13 milionë euro, pak a shumë e njëjta shumë që po



merr Robert Lewandowski. Oferta e Barcelonës për lojtarin do të ishte për dy sezone, ndonëse argjentinas do të kishte opsionin që në mënyrë të njëanshme ta ndërpresë kontratën pas vitit të parë. Messi, i cili përfundon

kontratën e tij me PSG-në në qershor, ka një ofertë befasuese nga Arabia Saudite dhe, gjithashtu, një propozim nga Inter Miami në MLS. Por Messi dëshiron që të paktën edhe dy vjet të tjera të luajë në Evropë.

## Denveri bën detyrën dhe u afrohet gjysmëfinaleve, Milwaukee e Memphisit rikthejnë ekuilibrat

DENVER, 20 PRILL - Denveri nuk gabon në dy ndeshjet e luajtura në fushën e tij, duke mposhtur me rezultat 122-113 Minnesotan dhe udhëheq 2-0 serinë e çerekfinaleve në Perëndim. Edhe pse Edwardsi realizoi 41 pikë për miqtë, ato s'mjaftuan për të fituar. Për Denverin u dalluan Murray me 40 pikë e Jokiqi me 27 pikë. Skuadra e Milwaukeees hakmerret ndaj Miamit, duke fituar me rezultat 138-122 në ndeshjen e dytë dhe barazoi në 1-1 serinë e takimeve. Shtatë lojtarë të



Milwaukeees realizuan mbi 10 pikë, duke bërë dallimin në parket, ndërkohë që nuk luajti Antetokounmpo, i dëmtuar në ndeshjen e parë. Barazim 1-1 me ndeshje edhe në duelin mes Memphisit dhe Lakersave, me të

parët që fituan me shifrat 103-93, duke rikthyer ekuilibrat. LeBron Jamesi realizoi 28 pikë e 12 rebounde, por i vetëm e pati të vështirë ta mposhtë Memphisin, ku të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë.

### "Play-off" Çerekfinale - Konferenca e Lindjes

Philadelphia - Brooklyn	(2-0)
Boston - Atlanta	(2-0)
Cleveland - New York	(1-1)
Milwaukee - Miami	138-122 (1-1)

### "Play-off" Çerekfinale - Konferenca e Perëndimit

Sacramento - Golden State	(2-0)
Memphis - Lakers	103-93 (1-1)
Phoenix - Clippers	(1-1)
Denver - Minnesota	122-113 (2-0)

## 14 lojtarë pritët të largohen nga Liverpooli

Liverpooli mund të humbasë 14 lojtarë këtë verë si pjesë e një ndryshimi të skuadrës. "Reds" nuk po shijon sezonin më të mirë, pasi nuk është në topkatërshe të Ligës Premier dhe shumë larg

objektivave. Është, gjithashtu, jashtë çdo gare të kupës, pasi pothuajse fitoi katër trofetë sezonin e kaluar. Sipas mediumit "Liverpool Echo", në afatin kalimtar të verës pritët të ketë një eksod

të lojtarëve. Roberto Firmino dhe Arthur Melo sigurt do të largohen. James Milner, Alex Oxlade-Chamberlain dhe Naby Keita janë gjithashtu afër largimeve, pasi nuk do t'u vazhdohen kontratat.

Fabio Carvalho mund të largohet në huazim, Caoimhin Kelleher dëshiron lojë të rregullt, Nathaniel Phillips dëshiron të largohet dhe Joel Matip mund të jetë afër fundit të karrierës së tij

në "Anfield". Rhys Williams, Kostas Tsimikas, Leighton Clarkson, Tyler Morton dhe Conor Bradley gjithashtu mund të shiten për t'i financuar blerjet e reja për trajnerin Jurgen Klopp.

### SHKURT

#### Interi kundër Milanit, Inzaghi: Gjysmëfinale ëndrrash

Simone Inzaghi merr frymë lirisht pas suksesit përballë Benfikës. Arritja e fazës gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve është sigurisht një hap shumë i madh në karrierën e teknikut zikaltër: "Është gëzim i madh, një mbrëmje e madhe për të gjithë Interin. Kemi bërë një ndeshje të madhe. E merituar të kalonim më tej kundër një skuadre të mirë që ka humbur vetëm dy ndeshje. Kjo gjysmëfinale ishte një ëndërr, por tani do ta jetojmë. Jam i lumtur për djemtë dhe për rrugëtimin që kemi bërë pasi dolëm nga një grup shumë i vështirë ndërsa ishim të gjithë bashkë". "Derbi me Milanin? Ta kemi përballë është një kënaqësi e madhe. Derbi do të jetë një stimul më shumë për ne", ka thënë Inzaghi.

#### Tucheli: Na mungoi fati

Bayern Muncheni është eliminuar nga Liga e Kampionëve pasi humbi ndeshjen e parë nga Manchester City me rezultat 3-0, kurse në ndeshjen kthyesë nuk arriti më shumë se një barazim 1-1. Trajneri Thomas Tuchel ka thënë se klubit gjerman i ka munguar fati në të dyja ndeshjet. "Mendoj se vendosëm në vështirësi sërish Manchester Cityn, e bëmë edhe në Manchester, por ashtu si një javë më parë nuk patëm në asnjë moment atë fatin që duhet në të tilla situata. Unë jam shumë i kënaqur me mënyrën se si u sollëm", u shpreh Tuchel.

#### Giroud vazhdon bashkëpunimin me Milanin

Olivier Giroud ka zgjatur bashkëpunimin me Milanin edhe për një vit tjetër. Ndonëse është pranë ditëlindjes së tij të 37, sulmuesi francez është gjithmonë edhe më vendimtar për skuadrën kuqezi. 13 gola ka shënuar Giroud në 27 ndeshje të luajtura këtë sezon. "Milani ka kënaqësinë ta njoftojë zgatjen e kontratës së Olivier Giroud. Sulmuesi është bashkuar me Milanin në verën e vitit 2021 dhe është bërë një pikë referimi në qendrën e sulmit kuqezi, duke shënuar 27 gola në 76 ndeshje të luajtura", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi. Francezi ka firmosur kontratën e re deri në qershor të vitit 2024 dhe do të përfitojë 3.5 milionë euro neto në vit.

#### Kampioni i botës humb jetën në luftën e Ukrainës

Nënkampioni i botës në kick-box, Ruslan Piskovij, vdiq duke luftuar kundër ushtrisë ruse. Detajet nuk dihen ende, ndërsa lajmi i hidhur është dhënë nga portale të shumta botërore. Piskovij ishte gjashtë herë kampion i Ukrainës në K1, finalist i Kampionatit Evropian K1, si dhe fitues i argjendit në Kampionatin Botëror K1. Ai garoi në kategorinë +70 kilogramë. Kampionati K1 është një garë në të cilën luftëtarat zhvillohen me një stil të përzier të ngjashëm me kikkboxin. Luftëtarët lejojnë të përdorin teknika boksi, kikkboxi, tajlandez, karate e taekwondo. Përpos që ishte nënkampion i Evropës dhe i Botës, ukrainasi ishte katër herë kampion bote në kikkbox dhe iu bashkua ushtrisë ukrainase si vullnetar që nga dita e parë e luftës me Rusinë.



## CONTRACT AWARD NOTICE SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 20 /04/2023

Procurement No	Research	001	2023	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

### SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

#### I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

<b>Official name:</b> Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
<b>Postal address:</b> str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1		
Town:Prishtina	Postal code:10000	Country:Kosovo
<b>Contact point(s):</b> Zef Shala		Telephone:044-128-277
Email:zefshala@hotmail.com		Fax:038-542-865
Internet address (if applicable):		www.matherteresasociety.org

### SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

#### II.1) DESCRIPTION

<b>II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:</b> Individual Research in 20 Selected Multi Ethnic Municipalities	
<b>II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance</b> (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)	
	<input checked="" type="checkbox"/> Services
	Main place of performance All Kosovo & Serbia according to the Request of Contracting Authorities
<b>II.1.4) Short description of the object of the contract</b> Individual Research in 20 Selected Multi Ethnic Municipalities	
<b>II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)</b> 93.000.000.-8 <input type="checkbox"/>	
<b>II.1.6) Division into lots</b> Yes <input checked="" type="checkbox"/>	
<b>II.1.7)Contract value:</b> Lot 1 15,000.00 Euro Lot 2 15,000.00 Euro Total 30,000.00 Euro	

### SECTION III: PROCEDURE

#### III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

#### III.2) AWARD CRITERIA

Lowest Price

#### III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

#### SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

<b>IV.1) Date of contract award</b> 20/04/2023		
<b>IV.2) Intended date of contract signing</b> 27/04/2023		
<b>IV.3) Number of received tenders</b> 3		
<b>IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded</b>		
<b>Official name:</b> "Lot 1 Leader Consulting & Services Prizren Lot 2 Centar for Democratic Development "Euroapolis" Novi Sad		
<b>Postal address:</b> 10000 Prishtinë		
Town:Prishtinë	Postal code:10000	Country: Kosovo
URL (if applicable):		
<b>Contact point(s):</b> Lot 1 Doruntina Muharremaj Lot 2 Dane Pribiç		Email:
Telephone:		Fax

#### IV.5) Information on value of contract

**Total final value of contract** 30,000.00 Euro  
Responsive tender with lowest price: 30,000.00 Euro  
Responsive tender with highest price: 34,000.00 Euro

**IV.6) The contract is likely to be subcontracted** No

### SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

#### V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092 ,at the address specified in Section I of this Contract award notice.



Kuvendi Komunal, Malishevë  
Drejtoria Komunale e Arsimit

Gjimnazi "Hamdi Berisha" -  
Malishevë



Nr. prot.: 55/23

Datë: 20.04.2023

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtë shkollore, Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë shpallë:

### OFERTË PËR EKSKURSION

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë shpallë ftesë për ofertë për zgjedhjen e agjencionit të udhëtimit për organizimin e Shëtijtes (Eskursionit) në Republikën e Shqipërisë me maturantë për vitin shkollor 2022/2023.

Kohëzgjatja e shëtijtes (ekskursionit) do të jetë 4 bujtje / 5 ditë, me pansion të plotë.

Në ekskursion do të marrin pjesë 363 nxënës.

#### Agjencioni duhet të plotësojë këto parakushte:

- Agjencioni duhet të jetë i licencuar.
- Të ketë fletëdëshminë e kontrollës teknike të autobusëve sipas procedurave ligjore.
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve, përparësi kanë autobusët me vitin më të ri të prodhimit.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendorë të ngasësve të autobusëve.
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe të ketë dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që i shoqëron nxënësit.
- Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit.
- Kategorizimi do të bëhet në bazë të kritereve dhe sigurisë për nxënësit, ku edhe do të vendoset për ofertën dhe vendin e vendosjes së nxënësve (hotelin), nga komisioni përkatës, ditën e hapjes së ofertës.
- Agjencioni duhet të prezantojë menynë ditore për secilën ditë të qëndrimit në Shqipëri të vërtetuar dhe nënshkruar nga pronari i hotelit.
- Kontrata në mes të agjencionit dhe hotelit.
- Një fletëkonfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar në mes të kompanisë dhe hotelit me datë të caktuar.
- Licenca e ballos (vallëzimit) e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit, ku nxënësit do të argëtohen.
- Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik dhe profesional.
- Vërtetimi i ATK-së.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në shëtitje (ekskursion).
- Agjencioni duhet t'i mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumentet historike.
- Agjencioni duhet të ofrojë dëshmi se në 12 mujorin e fundit ka pasur së paku qarkullim monetar 250.000 euro.
- Përparsi do të kenë kompanit lokale që jan tatim paguese të komunës sonë
- Nisja bëhet më datën 01.05.2023.

#### Ofertat të cilat nuk i përmbushin kriteret e kërkuara nuk do të merren në shqyrtim.

- Afati i aplikimit është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes nga data 21.04.2023 deri më 28.04.2023 (ditën e premtë).

- Ofertat pranohen në sportelin e DKA-së në Malishevë.

- Hapja e ofertave do të bëhet më 28.04.2023 ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00, në shkollë.

Malishevë

20.04.2023

Gjimnazi "Hamdi Berisha" - Malishevë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate  
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for  
Human Resources

07/1-01 SAP-R/516/2023  
Datë 18.04.2023

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 18/04/2023 me nr ref: DBN 07/025/2023, Policia e Kosovës për të gjitha minoritetet shpall:

## KONKURS

Për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptian, Kroat, Malazez, Maqedonas )

Vendi i punës: **Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri.**

**A. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet t'i përmbushin këto kriteret:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar);
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

### B. Testet:

- Testi me shkrim;
- Testi i aftësive fizike;
- Intervista;
- Testi psikologjik;
- Kontrollimi mjekësor;
- Verifikimi i të kaluarës.

### C. Në aplikim duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera;
- Certifikatën e lindjes/ekstrakt i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit apo pasaportës
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokument i nga pika **d** të i vlefshëm dhe të nxitur pas datës së shpalljes së konkursit.

### D. Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë

- Të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat;
- Të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- Të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
- Të parandalojnë dhe t'i zbulojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të hetojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë sigurinë në komunikacion;
- Të menaxhojnë dhe të kontrollojnë kufirin shtetëror;
- Të ofrojnë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- Të kryejnë detyra të tjera të parapara me Ligjin e Policisë.

### E. Forma e aplikimit:

Formularët për aplikim mund të merren në zyrat e personelit të drejtorive rajonale, në stacionet policore, ose të tërhiqen nga ueb faqja e PK-së: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com). Aplikacioni për konkurrim duhet të dorëzohet së bashku me kopjet e dëshmvive të kërkuara si më lart pika **C**, personalisht në zyrën e personelit pranë drejtorive rajonale në Prishtinë, Mitrovicë Jug, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan, Mitrovicë Veri dhe Gjakovë, çdo ditë pune prej **orës 09:00-15:00**.

Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë nga data **19/04/2023** deri me datën **12/05/2023 ora 16:00**.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 038-5080 lokali: 1002 si dhe 038/245-184, prej orës 09:00-15:00.

Pas përzgjedhjes së aplikacioneve kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimet e cekura më lart.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testimave do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, në adresën: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) dhe në tabelat e shpalljeve nëpër Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore përkatëse.

**Vëmendje:** Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet.

**“Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga këto minoritete”.**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate  
Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for  
Human Resources

07/1-01 SAP-R/516/2023  
Dana 18.04.2023

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o Radu Br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativnog Uputstva 01/2021 o Radnom odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9, tačka 1 i 2, i odobrenjem Generalnog Direktora od: 18/04/2023, pod ref. br: DLJI 07/025/2023, Policia Kosova za sve manjine objavljuje:

## KONKURS

Za prijem policijskih službenika po pretpostavkama konkurisanja za sve manjine (Srbi, Bošnjaci, Turci, Gorani, Romi, Aškali, Egipćani, Hrvati, Crnogorci, Makedonci),

**Radno mesto: Regionalna Direkcija Policia Kosova Mitrovica Sever**

**A. Kandidati koji se prijavljuju za policijske službenike u Policiji Kosova moraju ispuniti sledeće kriterijume:**

- Da bude Državljanin Republike Kosova;
- Imati 18-30 godina;
- Da ima završeno srednje obrazovanje;
- Da je u dobrom fizičkom, psihičkom, i emocionalnom stanju;
- Da nije osudjivan za krivično delo;
- Da nema tetovažu na vidljivom mestu (lice, vrat, ruke);
- Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti.

### B. Testovi :

- Pismeni test;
- Test fizičkih sposobnosti;
- Intervju;
- Psihološki test;
- Lekarski pregled;
- Provera prošlosti.

### C. Na aplikaciji, treba biti priloženi zahtevani dokumenti kao što su :

- Kopija diplome o visokom srednjem obrazovanju, dok za kandidate koji su obrazovanje završili u inostranstvo, nostrifikovanu kopiju diplome;
- Dokaz o drugim kvalifikacijama;
- Izvod / ekstrakt rođenih
- Kopija lične karte ili pasoša ;
- Fotografija formata (5 x 5);
- Dokument iz tačka **d** treba da je važeći i izdani nakon datuma objavljivanja konkursa.

### D. Dužnosti i opšta ovlašćenja Policie

- Da zaštiti život, imovinu i obezbediti sigurnost svih osoba;
- Da zaštiti osnovna prava i slobode svih osoba;
- Sprečavanje opasnost po građane i održavanje javnog reda i bezbednosti;
- Sprečavanje i otkrivanje krivičnih dela i njihovih izvršilaca;
- Da istražuje krivična dela i njihove izvršioce;
- Nadgleda i kontroliše bezbednost saobraćaja;
- Upravlja i kontrolisati državnu granicu;
- Pružanje pomoći tokom prirodnih katastrofa i drugih hitnih slučajeva i
- Obavlja druge poslove predviđene pa Zakonu o Policiji.

### E. Način apliciranja:

Obrasci za apliciranje mogu se uzeti u kancelariji osoblja regionalnih direkcija, u policijskim stanicama ili se preuzima sa službene stranice PK-a: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com). Aplikacija za konkurisanje treba da se dostavlja zajedno sa ostalom zahtevanom dokumentacijom kao u gore navedenoj tački C. Lično u kancelariji osoblja u regionalnim direkcijama u Prištini, Mitrovica Jug, Peć, Prizren, Uroševac, Gnjilane, Mitrovica Sever i Djakovica, svakog radnog dana od **09:00 do 15:00 časova**.

Zainteresovani kandidati mogu da apliciraju od **19/04/2023 do 12/05/2023 u 16:00 časova**.

Za detaljne informacije možete se obratiti na brojeve telefona: 038-5080 lokal: 1002 kao i na 038/245-184, od 09:00 do 15:00 časova.

Nakon selekcije aplikacija, uspešni kandidati će biti pozvani da učestvuju na gore navedenim testovima.

Informisanje kandidata u vezi svake faze testiranja biće objavljeno na zvaničnom sajtu Policie Kosova na adresi: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com) kao i na oglasnim tablama u Regionalnim Direkcijama i relevantnim Policijskim Stanicama.

**Pažnja:** Dostavljena dokumentacija se ne vraća.

**“Policia Kosova služi svim građanima Kosova. Ova služba pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i očekuje prijave svih osoba ženskog i muškog pola ovih manjina”.**



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Skripton Prushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Mazllum Këpuska" nga klasa e -I- deri në -IV- dhe -V- deri -IX-.

- Arben Kadrija shpall të pavlefshme dëftesën e viti të -I-, të shkollës së mesme SH.M.T. "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Arben Kadrija shpall të pavlefshme dëftesën e viti të -II- dhe -III- të shkollës së mesme Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Fatlind Krasniqi nga Rogova e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së -XII- dhe diplomën e Gjimnazit të lëshuar nga shkolla "Asllan Berisha" Rogovë.

- Ramiz Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -I I - IX, SHFMU "Dy Dëshmorët" Piranë.

- Elvis Bilibani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

- Kujtim Çoçaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Grojfi Gjidosi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën eplotë sh.f."Fan Noli" Dujak KK Gjakovë nga kl.I-VIII.

- Shkëlqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 sh.m. profesionale "Gjon Nikollë Kazazi" Gjakovë.

- "Royal" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810809733.

Visar Qenaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curi " Romaje.

- Beko Meta shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Izvor " Lubinje e Epërme.

- Sadete Musa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Jahë Salihu" Molliq KK Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

